

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

SHPRESA GJERGJI

FRAZELOGJIA SI SHPREHJE E NDRYSHIMEVE NË PËRMBAJTJEN E POEZISË

**(Vëzhgime rreth poezisë në vitet 90 – e deri sot: në fokus poezia
e Arqile Gjatës si sintezë e frazeologjisë dhe retorikës)**

Hyrje

Të përballesh me një refleksion rreth marrëdhënieve me “Personazhet” e poezisë së krijuesit Arqile Gjata, duke u përqendruar tek vëllimi i tij i fundit poetik “Lumenjtë janë të vjetër”, sigurisht, duhet të gjejmë një ekuilibër mes asaj që perceptohet nga autori dhe ajo çka përcillet tek lexuesi, nëpërmjet vargut poetik, fjalës së figurshme dhe asaj të drejtpërdrejtë si dhe filozofisë së intertekstit ku ajo kërkon dimension.

Së dyti do t’i mëshoja zgjedhjes së fjalës tek vëllimi poetik “Lumenjtë janë të vjetër”, si mjeti më i mirë shprehës dhe vendi ku i takon në poezinë e tij. Se sa e natyrshme dhe domethënëse është frazeologjia e përdorur dhe retorika e bukur që i jep hijeshinë poetikës, për t’u bërë e pëlqyeshme e sa më tërheqëse nën dritën e figurshmërisë dhe brumit artistik që përmban si edhe kuptimit semantik, domethënies së nënkuptuar të njësisë frazeologjike, me të cilin ajo përcjell mesazhin tek lexuesi.

Së treti do të veçoja se sa e vlerësuar është poetika e tij nga kritika e kohës, mendime të autorëve të tjerë për stilin dhe veçantinë e zgjedhjes së fjalës e frazeologjisë, duke e parë këtë të fundit në kontekstin konceptual e komunikues. Do të shtoja se shumëllojshmëria e tematikës i jep mundësi shprehëse retorikës së fjalës si një mundësi më shumë, e lidhur drejtpërsëdrejti me gjuhën si objekt në funksion të shprehjes e mendimit. Sipas prof. Terziut “poeti ynë flet qartë, ka stilin, gjuhën dhe vargun e tij”. Vlerësimet e shumta, interpretimet e ndryshme për frazën e Gjatës, punime poetike me vlerë në anglisht, italisht, greqisht, janë një ogur i mirë për sot e nesër, për ne dhe brezat që vijnë, në kritikën e kohës e më tej, si shprehje e vlerave semantike të njësisë frazeologjike të përdorura me mjeshtëri nga autori.

1. Vargu i lirë dhe gjuha retorike si shprehje e mendimit

Pikërisht këtu merr krah zanafilla e këtij punimi. Si autor i poezisë, Gjata i përkushtohet diskursit të fjalës së shpirtit, i del vetë, sikur fjala t’i buronte e të mos i shterte kurrë, ashtu si lumenjtë e poezisë së tij. Pasi i kam lexuar dhe rilexuar poezitë e tij, vë re se, që në titulli godasin bukur lexuesin, e tërheqin, e përlojnë, mbeten gjatë me brengën dhe gëzimet.

“Vargjet e tij janë një peshë e rëndësishme fjalësh, që ashtu si atëherë kur u shfaqën në poezinë evropiane, me emërtimin në gjuhën franceze (ku edhe ka lindur) vers libre – vargu i lirë. Këto vargje lindën atëherë, si shprehje e nevojës së

brendshme të poetit, si një domosdoshmëri e strukturimit të përmbajtjes, dhe tashmë në ciklin e Gjatës kanë një arsye më shumë të lindin e të fiksohen si të tilla, pasi ato pasqyrojnë botën e tij të brendshme e të ndjeshme. Ky strukturim i tij në poezi lidhet me poezinë moderne, që ushqehet pikërisht nga rrethana të tilla”, citon prof. Terziu në veprën e tij.¹

Nëse i referohemi shkrimeve të profesor Vangjush Ziko: “krijimtaria e tij poetike ka shkuar drejt rritjes dhe konsolidimit të verbit poetik, të cilën Gjata e zbulon me pozitivitet nëpërmjet një analize të detajuar, për të treguar vlerat e shumta të poezisë së tij si shprehje e mendimit retorik e gjuhësor”.

Në krijimtarinë e poetit Arqile Gjata *mbizotëron vargu i lirë, i figurshëm dhe unik në të cilin spikatin vlera artistike e sociale*, të cilat prezantohen thjesht dhe që autori i ka përzgjedhur për shumë arsye, të cilat do t’i theksojmë në këtë punim.

Sipas profesor Vangjush Ziko, tek “Fjala e lirë” on line: “Sot, në poezinë e shekullit tonë po fryn një erë e re (për më mirë apo për më keq, nuk e them dot) e poezisë postmoderniste, që ka në bazë mosbesimin dhe mosaprovimin, kritikizmin shpesh cinik, që e ka zhvleftësuar apo rivlerësuar arsenalin figurativ të poezisë së modernizmit, duke futur, sidomos intertekstin historik, mitologjik, e ka zëvendësuar metaforën (që është mbretëresha e poezisë moderniste) me metoniminë dhe entuziazmin me ironinë.” Është një dilemë e kohës për faktin se ka një çoroditje në mënyrën e të shkruarit këto vitet e fundit.

Ndryshe ndodh me krijimtarinë e poetit Arqile Gjata, i cili zotëron natyrshëm vargun e lirë. Jo vetëm se me të është më i lirshëm në krijim, po përgjithësisht sepse mbështetet në gurrën e pashtershme popullore, për të sjellë mendimin e për ta konkretizuar atë me gjithfarë mundësish, që gjuha e larmishme ia jep, dhe bota e tij intelektualizon frazën për të qenë vetvetja brenda kapacitetit të tij shpirtëror e shoqëror.

Prof. Ziko pohon (në një letër drejtuar autorit), jo vetëm që gjen një shumëllojshmëri të tematikës në poetikën e Gjatës, por vë theksin se “tematika shoqërore paraprihet nga tema patriotike, dashuria për vendlindjen, tema shoqërore, lirika intime vërtitet rreth kujtimeve dhe çasteve konkrete,... kudo ndjehet fryma lirike dhe meditative, të cilat janë aktuale; dhe ajo filozofike prek probleme të ekzistencës, të jetës dhe vdekjes; çaste, detaje të jetës, kujtime të zbuluara dhe të zbërthyer në prizmin e përjetimit lirik”.²

Nuk është aspak gabim të themi, se Gjata është një poet lirik modern, ku lirizmi i poezisë së tij ka një vel romantik, në kuptimin më të mirë të fjalës dhe një sharm përrallor, i përshkuar nga një ngazëllim i brendshëm i cili e shfaq atë nëpërmjet një gëzimi dhe mallëngjimi optimist, si shprehje e *eksternalizmit të emocioneve*. Kjo ndodh brenda mendimit gjuhësor të Gjatës, brenda shprehjes në poezitë e tij të shkruara, me fjalë të thjeshta e me botë shprehëse, ku spikat

¹ F. Terziu, *Kritika ndryshe, vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare* (2009), Arbëria, f. 311.

² V. Th. Ziko në letërkëmbim me autorin.

Frazeologjia si shprehje e ndryshimeve në përmbajtjen e poezisë

ndjeshëm formimi i bollshëm i njësive frazeologjike si shprehje botës dhe e mendimit të autorit.

Tek *“Lumenjtë janë të vjetër”*, e *“Kur thinjet deti”*, gjejmë frazeologji të tilla si: **i gëzohej vështrimeve** (i pëlqente kur e vështronin); **me sy të njomë** (me lotë ndër sy); **me gjoksin rritur nëpër ëndrra** (ëndërronte shumë), **të merrte shikimet e njerëzve të mirë** (donte ta admironin), **me krahe hedhur mbi dritën e njohjes, pashë veten time të vogël, sa një fije kashte** (të jesh i ditur do shumë punë për t’u bërë dikushi), **shpirtin ta bënë pasqyrë nga thinjat** (kur je i thinjur ke eksperiencën e viteve), **ku baret ajri i lirë**, (ku ndjehet liria), **e derdh trupin gjatë rrugëve rebele** (je fizikisht nëpër rrugët e jetës), **një buqetë mallëngjimesh**, (shume kujtime që të ngjallin emocion), **si u çel stuhia** (si pushoi stuhia), **rrë e sodis kujtimet** (kujtoj të shkuarën), **vendi im i mërzhitur** (kohë të vështira), **mu kujtua ikja e yjeve** (s’ka më dritë), **kafen e hidhur zjerë me lotë** (shpreh dëshpërim), **detet dhe ngjyrat urtësohen** (kur ka qetësi), **pret të shkruaj mes erërave, ngrohur nga drita e hënës** (pret kohë më të qetë), **qiellit të kaltër do t’ia dërgoj mesazhin** (beson ne Perëndi, në Zot), **sy mbërthyer për nga erdhën** (për nga e shkuara), etj.

Për sa i përket filozofisë së gjuhës, thekson prof. Rrokaj, “procesi gjuhësimit, nga njëra anë dhe ai i njohjes nëpërmjet gjuhës, nga ana tjetër, do të shiheshin të lidhur ngushtë me njeri tjetrin, në të gjithë dialektikën e zhvillimit të shoqërisë njerëzore”.³

Si e tillë gjuha shpreh dhe tregon për ecurinë e jetës në gjithë etapat e zhvillimit dhe dinamizmit që e karakterizon atë, dhe bënë që “individët të shtresëzojnë mbi gjuhën e bashkësisë, efektet e tyre individuale e kontekstuale”.⁴

Konsiderohet poezi e hapur dhe mjaft e natyrshme, dhe që brenda ka filozofinë e fjalës së mençur, të përdorur me stil, e mund të quhet edhe e sofistikuar e jo fort e matur dhe e rregullt në konturizimet e veta, ç’ka tregon më së miri botën e brendshme të poetit përmes pohimit dhe mohimit, jetës reale e asaj false, fjalës literale e asaj të nënkuptuar, si pjesë e botës reale brenda universit ku jetojmë. Disa nga punimet e tij, si: *“Arvanitas me shumë emër” Monografi për Aristidh Kolia, 2000*; *“Kur trazohet jeta” (vëllim poetik, 2005)*; *“Kurorë me ngjyra” (vëllim poetik, 2006)*; *“Qyteti që kërkon muzikë” (vëllim me tregime, 2007)*; *“Gratë e poetëve” (vëllim me poezi, 2009)*; *“Një ESE për Jetën” (vëllim me ese dhe mendime kritike, 2010)*; *“Jeta më vjen si poezi” (vëllim me poezi, 2010)*; *“Kur Thinjet Deti” (vëllimi me poezi, 2012)*; *“Lumenjtë janë të vjetër” (vëllim me poezi 2014)*, etj., janë një proces ripërtëritje i pandërprerë në krijimtarinë poetike të poetit Gjata, dhe shprehje e mendimit poetik që ia vlen të gërmosh pareshtur, për të nxjerrë në pah ato vlera specifike që e bëjnë këtë autor të veçantë në artin e fjalës dhe mendimit krijues si edhe të lëvrimin të njësive frazeologjike me motivim figuracional. “Poezia e tij, thekson prof. dr. Fatmir Terziu, vjen në kohën e duhur, e pjekur dhe jo e “zhuzhatur”, dhe e vlerëson

³ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës*, 2010, f. 232.

⁴ Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës*, 2010, f. 232.

veprën e tij duke i thënë autorit “je në lartësinë ku preken majat e poezisë shqiptare”.⁵

2. Frazelogjia dhe personazhet e Gjatës si pjesë e mendimit poetik

Gjuha në gojën e personazheve në poezinë e A. Gjatës, dallohet për mendimin dhe filozofinë që shpreh, pa pretenduar se gjithçka është thënë në mënyrë perfekte. Jeta dhe ëndrrat janë energjia brenda harkut konceptor që dakortësimi të vijë natyrshëm. Mendimet e tij, përgjatë rrjedhës së vargjeve, janë të thella si në perceptim ashtu edhe nëse i sheh ato në lëvizje të pandalshme. Ato shprehin vërtet një lloj dimension që të bëjnë të mendohesh e të thellohesh në gjykimin ndaj tyre (mendim, dinamikë, komunikim).

“Në poezinë e Gjatës ndihet edhe ndikimi surrealist, nëpërmjet metaforave që bëhen mbartëse të mesazhit. Ato flasin vetë, shpalosin kohërat e ngjarjet historike, shembnin themelet e ngrenë kështjella... Zgjojnë kujtime e të bëjnë të jetosh me to”, shpreh mendimin e tij estetik, Thanasi Boçi tek Studime letrare “E veçanta si njësi estetike”.⁶ Është jashtëzakonisht metaforik, që në titujt që ai përdor, mbi kopertinën e vëllimeve poetik të tij: *“Kur thinjet deti”, “Kurorë me ngjyra”, “Kur trazohet jeta”, “Lumenjtë janë të thinjur”,* etj. Pjesa gri e metaforës së përdorur jo vetëm që zgjon interes, e bënë tërheqës në sytë e lexuesit, por është fort e goditur për t’i dhënë mendimit gjerësi, larmishmëri, energji të brendshme, simbolizëm, etj., duke e zgjeruar komunikimin si pasojë e hamendësimit, për ta parë atë në kontekste të ndryshme ashtu sikurse mund të konceptohet nga vetë lexuesi. Në poezinë *“Lumenjtë janë të vjetër”* ai shprehet: *Lumenjtë janë të vjetër, / rrjedhin së bashku me gjumin dhe jetën absurde!* Në poezinë *“Disa orë në botën e panjohur”* autori na sjell fraza e njësi frazeologjike brilante të tilla si: *Si guaskë jetova disa orë / Në botën e panjohur ëndërroja ëmbëlsinë, / se si pasqyrohej dashuria!* Vargjet e Gjatës janë të tejmbushura me frazeologjizma, por gjithmonë me masën e një bote të pa tepruar e të pranueshme për nga bukuria e përzgjedhjes së frazës dhe leksikut të përdorur gjithë fines në të. Njësi të tilla të motivuara figurativisht si: *“si guaske jetova”* – (i mbyllur), *“në botën e panjohur”* – (me të papritura), *“ëndërroja ëmbëlsinë”* – (ndjehet fryma e optimizmit, kërkon një botë tjetër nëpër ëndrra), *“si pasqyrohej dashuria”* – (krahësim i figurshëm për të shprehur dëshirën që dashuria t’i kthehet edhe atij), bëjnë që gjuha retorike e autorit në poezitë e tij të jetë tejet shprehëse e domethënëse: *“Vargje guri”* Prej racës së gurit jemi, / veshur me kostum guri, të rëndë, të fortë. / Qielli me gurët është në armiqësi...! Njësitë frazeologjike: *“vargje guri”*– (nj. frazeologji. e motivuar me metafore dygjymtyrëshe, emër + emër me kuptimin e figurshëm që nuk vdesin kurrë); *“race guri”*– (nj. frazeologjike, e motivuar me metaforë, dygjymtyrëshe, emër + emër, me kuptimin, të fortë: *“veshur me kostum guri”*– (nj. frazeologjike, e motivuar me metaforë, e përbërë nga një mbiemër përpjesor + emër + emër, me kuptimin metaforik që guri si simbol e përcjell me fortësinë, me

⁵ A. Gjata, *Kur thinjet deti*, 2012 (parathënie, F. Terziu), f. 8.

⁶ Th. Boçi, 2014, *Studime letrare, e veçanta si njësi estetike*, Milosao, f. 12.

Frazeologjia si shprehje e ndryshimeve në përmbajtjen e poezisë

traditën, me qëndresën, me kulturën etj.), i jep poezisë forcën e fjalës e të mendimit.

Tek poezia “**Imazhe**” / Kur shpresa e një dite të re / zvarritej këmba-doras drejt diellit, / Ai, burrë i ndershëm, ndjente freski!

Njësitë frazeologjike “*shpresa e një dite të re*”, “*zvarritej këmba-doras*”, “*ndjente freski*” jo vetëm që i japin vlera semantike leksikore poezisë, por e bëjnë të veçantë edhe për mënyrën e vendosjes së tyre në fjali. Fraza e tij, e përdorur brenda **tercinës** (vargu tresh), ka në thellim të saj konceptin semantik, figurshmërinë e mrekullueshme dhe intertekstin filozofik; një frazë e thjeshtë, brenda një mendimi të madh. Nëpërmjet frazeologjisë së figurshme si p.sh:

“*m’u kujtua ikja e yjeve*”, “*eshtrat mi mbillni buzë detit*”, “*ka filluar të më vdes koha*”, “*lexoj dritën e atij çasti*”, “*deri në qiell bubullimat e armëve kërcejnë*”, “*ne ende jetojmë në forma të zbrazëta, jemi vdekja dhe fabula e kapitalit*”, “*syri i diellit të më shuaj mallin*”, “*vdekja-ëndërr! Na vjen për të qarë, çelësin e saj e kemi tatuazh në gjoks*”, “*me sy si vezë të qelqta*”, “*pasqyra ecjen ngatërro*”, “*sytë e miqësisë me zarfin e ëndrrave m’i dërgo*”, “*dua pak fresk, derën e ajrit hapur e kam*”, “*deti i thinjur me të qeshura të çmendet*” etj., autori kërkon nëpër labirinte mendimesh të sjellë botën e brendshme të tij (eksternalizmi i emocioneve), me brenga dhe gëzime, dhe këtë e bënë nëpërmjet një uni poetik të papërsëritshëm, që ai vetë e ka ngritur si një kështjellë brenda së cilës, ka akumuluar historinë e saj, të ngërthyer pas mureve e pas gurëve të saj të moçëm e antik, madje edhe ajri brenda saj ka frymën e historisë që e bënë të veçantë në unin e vet poetik lirik.

Është një “egoizëm” të cilin lexuesi e pëlqen dhe e do si formë e reflektimit dhe komunikimit brenda botës së tij. Është një dukuri, një simpati e empati, që vërehet nga lexuesi, finesa e poezisë së tij të bënë ta duash këtë lloj “egoizmi”, në poezi! Në këtë mënyrë, ai evidenton dhe evidentohet, tregon të veçantën, atë të papërsëritshmen tek të tjerët.

Duke qenë se poezia moderne lë shumë hapësirë e terren që të luash me fjalën, me mendimet, me figurat letrare, si rrjedhojë “personazhet” e autorit (A.GJ) janë shumë emocionalë. Ato kanë dëshira, teka, pasione e komoditet, çdo varg sjell arsyen për të medituari, ëndërruar, të grindesh me heshtjen dhe të “**trazosh detin**”; natyrën në çdo stinë e sheh pjesë të komunikimit mes “gjuhës së personazheve”, të cilat janë herë konkrete e herë abstrakte, herë njerëz (*mjeshtri i mashtrimeve, i moshuari, bujku, të poshtëruarit, idealisti, e dashura, madje edhe Migjeni, edhe ai vetë, autori, është personazh i poezive të tij*), e herë personazhe metaforik si: *mure, qytete, gurë, dritare, deti, mizat e dheut, shpirtërat, yjet, fshati, pranvera, lulet* etj., që sjellin dukuri me tematika nga më të ndryshmet, brenda metaforave e figurave letrare shumë të bukura e interesante, që i japin frazeologjisë vlerat e duhura në ligjërim.

Personazhet tek “*Lumenjtë janë të vjetër*”, flasin, dashurojnë, ëndërrojnë shumë madje, janë të brendshëm në koncept dhe të jashtëm në dukje. Brenda botës shpirtërore të njeriut gjen atë të imagjinuarën, e cila godet veset e shoqërisë, madje ka edhe revoltë, e cila evidentohet dukshëm në vargjet e tij: “*Ne jemi të gjithë*

zota, zjarrin duam të ndezim”, tek poezia “Një tjetër Zot do pikturojmë”, ose tek poezia “Koha ecën”, vargu i tij gjëmon: *“Ejani...t’ia ndërtojmë muzeun”*, etj. Stina e luleve për “personazhet” e tij është një botë e mbushur me ‘ar të pastër’ në vargjet që ai ka shkruar! Të gjithë “personazhet” shfaqen, përshkohen, ushqehen me ajrin e frymëzimit. Dhe pikërisht është kjo, që lexuesi ndjen, muza e tij poetike, frymëzimi i autorit si ajo lulja kur çel, gjithë nur e aromë, kjo pra, është ajo veçanti që e bënë të lexuar e të vlerësuar atë.

“Personazhet” e poezive të Gjatës..., janë zhytur thellë në botën e pikëpyetjeve dhe pse e shijojnë më së mirë fshehtësinë e kësaj bote, edhe pse nuk munden t’i prekin ato (pikëpyetjet), e as t’u afrohen, edhe pse ato janë interesante. Ato jetojnë kudo, nëpër enigma apo atje, ku *“bukuria u pëlqen syve dhe butësia të magjeps shpirtin”*. Ato jetojnë ku ka *“festa”*... *“nëpër dritëmuret e qyteteve”*...ose, ose *“në shtëpinë e të çmendurve”* dhe padyshim janë pjesë e realitetit njerëzor. Në këtë kontekst, na vjen si *ekzistencialist*, duke sjellë njeriun e kohëve moderne mes dilemave e udhëkryqeve të pazgjidhshme. “Personazhe” që janë sa projektues, aq edhe të ankthshëm, sa mediokër edhe të urtë, sa pasionantë edhe të lodhur e apatik, çalë-çalë e dembelë, pasi ato, *“ecin me qerre në një botë me tym”*, gjithë labirinte. Ky është kontrasti i kohës që jetojmë sot... *“Stilistika letrare e poezisë së Gjatës është një funksion i qartë dhe një harmoni e nevojshme në lidhje me gjithë detajet e poetikës. Këtu merr jetë poezia e tij dhe mbetet si një krijim ritmik i botës së tij të brendshme e të ndjeshme”, thekson Terziu në parathënien e vëllimit poetik*.⁷

Akoma s’do të reshtja së thëni se gjuha e “Personazheve” në vëllimin poetik i bënë ato “kokëkrisur”, sa që kanë dalë nga rreshtat simetrike të traditës, ata kanë hapin e mendimit, forcën e figuracioneve, elegancën e fjalës së qëmtuar, ngjyrimet dhe nuanca të dukshme e të padukshme, kanë brenda gufimin e fshehtë të detërave dhe gjithë absurditetin e *“qyteteve sferike”*.

Gjuha dhe frazeologjia tek *“Lumenjtë janë të vjetër”*, në përfytyrimin e personazheve tregon se ato nuk janë prej guri, ato thyhen para së bukurës dhe patjetër janë edhe të vjetër, kanë brenda tyre histori, rrjedhin së bashku me lumin dhe jetën, duke siguruar kështu ekzistencën dhe përjetësinë! Kanë dhimbje... *“janë të pangrëne, era i shkund, si gjethe këputen...e një këngë shiu për ta vajton”*. Përmes mendimit, ato komunikojnë, prezantohen të thjeshtë, elegantë dhe fisnik, shprehës dhe frymëzues! “Personazhet e poezive *“Ne nuk ikëm...”* dhe *“Dua të t’kujtoj”* me japin mundësinë të kuptojmë se tashmë ato ...kanë një hapësirë më të gjerë, kanë arritur të kapin sensin e komunikimit kulturor mes vargut. Një sens që arrihet nga dihamat e saj metaforike, tërë arkitektura poetike, logjika, gjuha dhe figurativiteti. Madje, edhe shenjat e pikësimit flasin me gjuhën e tyre. Me tre pikat e përdorura, si në fillim të frazës dhe hera-herës edhe në fund të saj, autori kërkon të zgjerojë mendimin, të nënkuptojë më shumë nga ç’është thënë, për të bërë atë, që gjuha e drejtpërdrejtë, jo gjithmonë e bën. **Këto personazhe** - vlerëson me fjalën e tij, prof. Fatmir Terziu, e gjejnë forcën mes

⁷ A. Gjata, 2009, *Gratë e poetëve*, ADA (F. Terziu, parathënie), f. 6.

Frazeologjia si shprehje e ndryshimeve në përmbajtjen e poezisë

diskursit që paraqitet në lidhjen e tyre të komunikimit gjuhësor me anë të shqisave. Ato janë të lidhura me arsyen e këtyre lëvizjeve dhe kuptimësia e tyre qartësohet që në leximin e parë.⁸

“Ne nuk ikëm” Ne nuk ikëm.../ Ishte mjegull, dremiste moti, / Unë qeshja me thashethemet e mjegullës. /Ndërsa ti meditoje kohën duke vështuar retë, Si treteshin mbi kokat tona!

Ne përsëri nuk ikëm, / Edhe kur qielli u bë mermer. / Si dy banorë të pastrehë / Ngroheshim nga fryma jonë, / Bëheshim këngë...

Që në fillim, gjuha konceptohet moderniste; konceptohet si një bashkëbisedim unik lirik me vetveten e më tej me qenien njerëzore. Ndihet dukshëm ndryshimi mes poezisë së realizmit socialist e poezisë moderne sot. Tematika, koncepti objekt-subjekt, mbi të cilin ndërtohet ky subjekt, ndërthurja e frazave dhe prezantimi i kuptimit nëpërmjet tyre, njësitë frazeologjike të motivuara apo jo figurativisht, të lira apo të gjalla e unike, e sjellin poezinë me kuptimet dhe nënkuptimet, duke zgjuar tek lexuesi emocion. Ndryshe nga poetë të realizmit socialist, ku mbizotëronin rregulla të forta e të mirëpërcaktuara dhe ku kemi një rimë të lëvruar dukshëm, poeti ynë i mëshon ritmit të brendshëm, botës së pasur shpirtërore, e mbi të gjitha një fraze tejet domethënëse, të pasuruar me vlera artistike të shkëlqyera. Metaforizmi si edhe përdorimi i figurave të tjera letrare kanë shprehinë e tyre të stisur. p.sh. ... *“dremiste moti”, “unë qeshja me thashethemet e mjegullës”, “duke vështuar retë si treteshin mbi kokat tona”, “kur qielli u bë mermer”, “ngroheshim nga fryma jonë e bëheshim këngë”* etj. Shprehësia e fjalës brenda frazës, shprehje të tilla frazeologjike me ngjyrim brenda kontekstit, vijnë si një mendim i thellë, për ta shprehur atë me thellësinë e oqeanit, që sa më shumë zhytesh, aq më shumë kuptime ka, sa më shumë analizon, aq më shumë interpretime socio-kulturore bënë, ku komunikimi me lexuesin, vjen i gjallë e vital.

“Personazhet” e bëjnë transparencën në praninë e tyre, gjë që tregon personalitetin letrar në harmonizim me mendimet që përvidhen nëpër damarët e figuracionit. “Ndonëse metaforat nuk shërbejnë vetëm si forma artistike mbretëruese, por e kanë mprehtësinë e mjaftueshme sa të drejtojnë lexuesin te objektivi, ku padyshim, fshihet mesazhi autorial. Ai mesazh vjen si një mendim i posaçëm, largpërçues, dritëdjellës dhe në pikëtakim me realitetin të ngulit perceptimin e diçkaje të brendshme në shpërthim, të përçueshmërisë së atij mendimi jashtë kontureve të personales” - shprehet profesoresha, Zejnepe Ali Rexhepi.⁹

...“Personazhet” e poetit Gjata prej vitesh kanë folur mjaft qartë. “Madje ato kanë lidhje edhe me krijimtarinë e hershme poetike shqiptare, që tentoi këtë shmangie nga tradita e vargëzimit. Asdreni tek “Psallmë murgu” (1930), krijoi dhe strukturoi në këtë mënyrë. Kadare krijoi “Llora” dhe në mënyrë perfekte realizoi

⁸ F. Terziu, *Kritika ndryshe, vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare* (2009), Arbëria, f. 310.

⁹ Z. Ali Rexhepi, *Refleksione lirike*, 2014, Tetovë.

një dukuri që tashmë duket e zakonshme në poezinë e Gjatës. Poezia “Llora” e Kadaresë ka një ngjashmëri në strukturë dhe në filozofinë e shprehjes me poezinë e Gjatës “*Poetët e Harlisur*”, thekson e vlerëson në studimin e tij “*Kritika ndryshe*”, Prof. F. Terziu.¹⁰

“Poetët e Harlisur”: Poetët e harlisur / brigjeve të fjalës, / dhëndurë të poezisë syshkuar,

mos ma prishni buzëqeshjen e varrit të nënës. / Nga cepat e vargjeve rrëshqasin lot dhe shpresë,

*Jo copra litari për fjalën e lirë...!*¹¹

Spikasin metafora shumë të veçanta e të gjalla e na japin tablonë poetike të ekzistencializmit e eksternalizmit të ndjenjës se brendshme të autorit, të paraqitjes së domethënies e shprehjes së mendimit, të konceptimit të veprës e poezisë së këtyre viteve, si lirikë e kohëve moderne. Këtu poezia është e lirë, poezia është e vërtetë, jo konformizëm, jo litarë për fjalën e lirë.

3. Si rezultat:

Një shprehje thotë: “Poezia është krijimtari ritmike e së bukurës në fjalë”. Dhe gjithë sa më sipër, ajo e kryen këtë mision të fjalës dhe shpirtit me shpirtdhimbjen e poezive post moderniste bashkëkohore, ku poeti Gjata e gjen veten denjësisht, brenda frazës së përdorur me shumë mjeshtëri.

Dhe po e përfundoj me një thënie të prof. V. Memisha se “metafora e abstraktimi kuptimor marrin përmasa të reja, gjuha shpërfaq mundësitë e veta dhe intelektualizohet, pavarësisht se burimi i njësive frazeologjike shpesh është i drejtpërdrejtë nga gurra popullore”¹², ashtu si edhe poeti Gjata e lëvront atë dhe e sjell në poezinë e tij gjithë sharm e të skalitur me një nivel të vlerësueshëm së tepërmi.

Konkluzione:

Në poezinë e tranzicionit:

- Shprehësia frazeologjike vjen më e pjekur dhe e arrirë në shumëllojshmërinë e saj nëpërmjet vargut të lirë.
- Komunikimi është më i thellë dhe më i shpejtë.
- Metaforizmi i njësive frazeologjike, e bënë këtë komunikim më të shpejtë se sa literalisht.
- Interpretimi i frazës varet nga konteksti dhe faktorë socio-kulturor, dhe fraza vjen semantikisht me domethënien e saj kuptimore si edhe me sinonimitet.
- Edhe pse s’ka rimë metrike, ritmi dhe muzikaliteti i frazës vjen natyrshëm me forcën shprehëse të kuptimit apo të nënkuptimit nga interpretimi që mund t’i bëhet asaj.
- Vargu i lirë, përdorimi i vrullshëm i njësive frazeologjike, shumëkuptimësia e tyre dhe abstraksioni i japin dimension poezisë.

¹⁰ F. Terziu, *Kritika ndryshe, vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare* (2009), Arbëria, f. 311.

¹¹ A. Gjata, *Gratë e poetëve*, 2009, ADA, f. 16.

¹² V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, 2011, Botart, Tiranë.

Frazeologjia si shprehje e ndryshimeve në përmbajtjen e poezisë

BIBLIOGRAFI

- A. Gjata, *Gratë e poetëve*, 2009, ADA, Tiranë.
A. Gjata, *Kur trazohet jeta*, 2005, Enalen, Athinë.
A. Gjata, *Kur thinjet Deti*, 2012, ADA, Tiranë.
A. Gjata, *Kurorë me Ngjyra*, 2006, Neraida, Tiranë.
A. Gjata, *Lumenjtë janë të vjetër*, 2014, Vllamasi, Tiranë.
A. Gjata, përkthyes: Hysa, Spaho, Suzana, *Nella Note di Primavera*, 2015, Triptik.
A. Gjata, *Qyteti që kërkon muzikë*, 2008, Triptik, Vlorë.
F. Terziu, *Kritika ndryshe, vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare*, pj. I (2009), Arbëria.
Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës*, 2010, Arbëria.
Th. Boçi, *Studime letrare, e veçanta si njësi estetike*, 2014, Milosao, Sarandë.
V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, 2011, Botart, Tiranë.
Z. A. Rexhepi, *Refleksione lirike*, 2014, Tetovë.